

**ALBANA MEMA****KRIZA INSTITUCIONALE DHE KARAKTERI  
I QEVERISË SË FAN NOLIT****Abstrakt:**

*Ky artikull trajton formimin dhe funksionimin e institucioneve dhe formës së qeverisjes në Shqipërinë e qershorit të vitit 1924. Më tej analizohet edhe karakteri diktatorial i qeverisë së Nolit edhe pse për shkak të përçarjeve të thella të brendshme, fuqia e saj ishte e limituar dhe madje në disa raste mori trajta anarkiste.*

*“Statuti i Zgjeruar i Lushnjës” parashikonte se, çdo qeveri e krijuar duhej të legjitimohej më parë, përmes votimit në parlament. Qeveria e drejtuar nga Noli nuk mund ta plotësonte këtë kërkesë, pasi parlamenti ishte i shpërndarë prej grushtit të shtetit dhe qeveria nuk dëshironte ta mblidhte. Për pasojë, qeveria e Nolit, mbetet unike në historinë e qeverive shqiptare të viteve 1920-1925. Ajo është e vetmja qeveri, e cila nuk është dekretuar nga kryetari i shtetit (Këshilli i Lartë) dhe nuk është votuar as formalisht në Parlament.*

**Fjalë kyçe:**

Shqipëria, shteti, institucionet, grusht shteti, forma e qeverisjes, parlamenti, qeveria, Këshilli i Naltë, Fan Noli, Ahmet Zogu

**Institucionet dhe forma e qeverisjes  
pas qershorit të vitit 1924**

Qershori i vitit 1924 përmbysi përfundimisht sistemin e krijuar nga Kongresi i Lushnjës dhe i hapi rrugën zhvillimeve tepër kaotike dhe të pakontrolluara në politikën shqiptare. Qeveria e Nolit, krahasuar me qeveritë e mëparshme të periudhës 1920-1924, ishte qeveria kryesore jokushtetuese.

Në fushën e qeverisjes, Shqipëria me Nolin bëri një hap mjaft të madh prapa, i cili pati pasoja negative në të gjitha institucionet e tjera. Marrja e postit të kryeministrit nga Noli ishte në kundërshtim të plotë me Statutin e Lushnjës dhe për pasojë, tërësisht e paligjshme. Në këtë kohë, krahas parlamentit, ishte shpërndarë edhe Këshilli i Lartë, i cili kishte qenë një organ funksional dhe i pranuar, para ngjarjeve të qershorit. Kështu, ishte krijuar një vakuum i rrezikshëm institucional, si rezultat i shkatërrimit të dy shtyllave kryesore të shtetit: Parlamentit dhe Regjencës. Ky fakt, së bashku me angazhimin e ushtrisë për përmbyshjen e qeverisë së mëparshme legjitime, ishin të mjaftueshëm për ta cilësuar qeverinë e Nolit, si një qeveri të paligjshme dhe ardhjen e tij në pushtet, si një grusht shteti.<sup>1</sup> Mungesa e një programi politik, social dhe e kohezionit politik është një argument tjetër i fortë që kryengritja e qershorit të mund të konsiderohet thjesht një kryengritje antiqeveritare me tiparet e një grushti shteti, dhe jo një revolucion.

Në tekstin “Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri”, ndër të tjera analizohet edhe forma e qeverisjes që u aplikua në vitin 1924. Edhe pse pranohet se qeveria ishte drejtuesja e vetme e vendit, përsëri aludohet fakti se “*de jure*” gjatë kësaj periudhe u ruajt forma monarkike. Sipas këtij teksti, *de jure*, edhe gjatë qeverisjes së Nolit u ruajt forma monarkike e shtetit, e përfaqësuar nga Këshilli i Lartë. Megjithatë, nga përmbajtja dhe nga prirjet e saj të përgjithshme, Qeveria Demokratike e 1924-ës ishte mishërim i një koncepti republikan demokratik. Në kushtet kur Asambleja Kushtetuese ishte shpërndarë dhe Këshilli i Lartë mbeti një organ formal, pothuajse pa jetë, qeveria e Nolit ishte drejtuesja e

<sup>1</sup> Grushti i shtetit (frëngjisht “Coup d’Etat”) nënkupton ndërrimin e qeverisë me dhunë nga individë apo një grup njerëzish të cilët ndodhen në pozita të larta shtetërore apo ushtarake. Ai është një shkelje e legjitimitetit institucional mbi të cilin është ndërtuar shteti, si formë e organizimit politik dhe rregullave ligjore me të cilat qeveriset. Grushti i shtetit dallohet nga revolucioni për arsye se kryhet “nga lart” nga aparati shtetëror ose një pjesë e tij, kryesisht ushtria.

<https://www.britannica.com/topic/coup-detat>;

[https://www.treccani.it/enciclopedia/colpo-di-stato\\_%28Enciclopedia-Italiana%29/](https://www.treccani.it/enciclopedia/colpo-di-stato_%28Enciclopedia-Italiana%29/).

Qershori i vitit 1924 në këtë këndvështrim ishte një grusht shteti, pasi në përmbyshjen e qeverisë rol kryesor luajtën dy regjimentet ushtarake. Por, meqë në kryengritje morën pjesë edhe forca civile të drejtuara nga krerë të opozitës, ngjarjet e qershorit kanë një karakter miks të një kryengritjeje antiqeveritare dhe të një grushti shteti. Prandaj në vijim të këtij artikulli ne do t’i referohemi kësaj ngjarjeje me të dyja këto terma.

vetme e tërë jetës politike, ekonomike e shoqërore të vendit.”<sup>2</sup> Por, pikërisht për këtë arsye, nuk mund të pranohet se këtu kemi ruajtjen, qoftë dhe formale, të sistemit monarkik. Kjo sepse, megjithëse formalisht shpallej se Këshilli i Lartë ekzistonte, në realitet, ai nuk funksiononte as *de jure* dhe as *de facto*.

Në muajt e qeverisjes së Nolit, degradimi i Këshillit të Lartë ishte i plotë. Tre anëtarët e këtij këshilli për shkak të kryengritjes u detyruan të largohen jashtë vendit pa dhënë dorëheqjen. Mbeti vetëm njëri prej tyre, Sotir Peci, veprimtaria e të cilit nuk mund të konsiderohej si veprimtari legjitime e Këshillit të Lartë. U krijuan dilema mbi legjitimitetin e anëtarit të mbetur dhe kompetencat e tij për të dekretuar mbajtjen e zgjedhjeve politike në dhjetor 1924. Të drejtat e ushtrimit të funksionit të këtij institucioni, në bazë të nenit 51 të Statutit të Zgjeruar të Lushnjës, i ushtronte anëtari i mbetur. Por, kjo situatë mund të vazhdonte vetëm për një periudhë të jashtëzakonshme. Nga ana tjetër, mandati i Këshillit përfundonte më 23 dhjetor dhe në mbështetje të neneve 44, 51, 55, duhej të zgjidheshin anëtarët e rinj.<sup>3</sup> Në këtë mënyrë, ai jo vetëm u zhduk si institucion por, edhe u keqshfrytëzua nga qeveria, duke uzurpuar kompetencat dhe duke e tjetërsuar natyrën e tij.

Gjithashtu, përveçse duke u bazuar në koncepte ideologjike,<sup>4</sup> kjo qeveri kurrsesi nuk mund të quhet demokratike. Kjo ishte një qeverisje diktatoriale pa një formë kushtetuese. Ajo funksionoi si një qeveri e paligjshme, e cila sfidoi Asamblenë Kushtetuese dhe sistemin parlamentar kushtetues të vendosur pas Kongresit të Lushnjës.<sup>5</sup>

Noli, pa dyshim ishte një njeri i ditur e i kulturuar, por pa përvojën e jetës shqiptare. Ai pati dështimin më të madh të jetës së tij, në gjysmën e dytë të vitit 1924. Qeverisja e tij kishte një dallim të madh mes programit në letër dhe realizimit të tij. Në fakt, me përjashtim të një grupi të vogël që kishte pikëpamje të tilla dhe të një programi të afishuar por tërësisht të

<sup>2</sup> *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, grup autorësh, pjesa II-të, Tiranë: Luarasi, 1994, f. 344-346.

<sup>3</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 146, Viti (më tej: V.) 1922, Dosja (më tej: D.) 85, fl. 1-32. Statuti i Zgjeruar i Lushnjës. Tiranë, 8 dhjetor 1922.

<sup>4</sup> Në botimin e Akademisë së Shkencave të vitit 2007, qeveria e Nolit është paraqitur si demokratike.

<sup>5</sup> *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. II, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2019, f. 315-322.

parealizuar, ajo s'mund të vlerësohet si demokratike. Në këtë rast, veprimtaria e saj dhe mënyra se si erdhi në pushtet janë përcaktuese në vlerësimin e karakterit të qeverisë.

E krahasuar me qeveritë e mëparshme, kjo qeveri, ishte më e përçara dhe njëkohësisht, përveç legjitimitetit, asaj i mungonte kohezioni e për pasojë edhe energjia qeverisëse.<sup>6</sup>

Në ditën e triumfit të kryengritjes, ministri britanik në Shqipëri, Harry Eyres e vlerësonte krejtësisht me ngjyra të zymta situatën e krijuar. Ai informonte kryeministrin britanik se: "*Qeveria aktuale është e dobët, e ndarë në grupe dhe elementët shkatërrimtarë kanë marrë avantazh për këtë fakt*".<sup>7</sup> Eyres fokusohej tek personaliteti i dytë kryesor i qeverisë pas Nolit, - pikërisht tek Gurakuqi për të cilin bënte një analizë tepër kritike. Në lidhje me të, ai shkruante: "Luigj Gurakuqi, deputet i Shkodrës, i cili është agjent i françeskanëve në veri, duhet pranuar, që për një arsye ose për një tjetër, e lejoi veten të përdoret si propagandist politik, fillimisht nga austriakët dhe pastaj nga italianët. Gurakuqi është gjithmonë nën protektoratin italian. Ai ishte ministri i fundit i Financave për pak javë dhe më pas dezertoi nga qeveria dhe shkoi në Shkodër, bashkë me të gjithë deputetët e tjerë, me qëllimin që ta bënte Asamblenë Kushtetuese joefektive."<sup>8</sup>

Diplomati britanik ishte i mendimit se një numër i konsiderueshëm deputetësh nuk kishin inteligjencë të mjaftueshme për të parë sjelljen e tyre dhe pasojat që ajo kishte ndaj shtetit dhe institucioneve të tij. Atyre u mungonte kohezioni dhe në këtë mënyrë bëheshin lehtësisht pre e intrigave të të huajve. "Në këto momente, Ahmet Zogu është objekt i një fushate të paskrupullt shpifjesh dhe çdo krim që urrehet dhe frika që shpiket, i janë ngarkuar atij",<sup>9</sup> deklaronte Eyres. Ai kishte ardhur në përfundimin se situata e Shqipërisë ishte e rrezikshme dhe mendonte se nuk kishte mbetur asnjë alternativë tjetër për të ndaluar konfliktet e pareshtura dhe shpërbërjen e Shqipërisë, përveç vendosjes së një diktature personale me në krye A. Zogun. Në përfundim të këtij raporti, ai i shkruante Kryeministrin britanik: "Pamja politike aktuale është jashtëzakonisht e zymtë. Për momentin nuk shoh asnjë mundësi për

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 317.

<sup>7</sup> *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Foreign Office (më tej: *FO*) 371/9644, fl. 1290-1293. Telegram i Eyres për Macdonald, Durrës, 10 qershor 1924.

<sup>8</sup> *Po aty*.

<sup>9</sup> *Po aty*.

formimin e një qeverie me njerëz të arsyeshëm, energjik dhe inteligjentë. Një diktaturë me Ahmet Beun që në fillim, mund ta shpëtonte situatën, por nuk është një politikë praktike dhe jeta e tij do të ishte gjithmonë në rrezik. Me sa duket, një fraksion do të ketë sukses mbi tjetrin dhe qeveria gjithmonë do të jetë e dobët dhe joefektive.”<sup>10</sup>

Në fillim të qershorit 1924, u duk se Shqipëria, kishte bërë një shkëputje thelbësore nga e kaluara, se reforma e vërtetë ishte një mundësi reale dhe se një epokë e re po shfaqej në horizont. Sigurisht, kështu e shihnin situatën disa udhëheqës, veçanërisht Noli. Megjithatë, çështjet themelore nuk kishin marrë përgjigje dhe ardhja e Nolit në pushtet ishte e sipërfaqshme. Vënia në jetë e rendit të ri kërkonte një grup shumë më koheziv, se sa ai që drejtonte Noli dhe ligjvënës të aftë, me dëshirën e mirë për të bërë sakrificat dhe kompromiset e nevojshme. Kështu që Nolit i duhej hapësirë e gjerë për frymëmarrje, për të arritur me sukses krijimin e një Shqipërie, siç e përfytyronte ai. Ndërkohë që në situatën e mëtejshme, po bëhej akoma më e qartë se ai nuk i kishte dhënë goditjen përfundimtare klasës sunduese, se fqinjët e shihnin fitoren e tij me frikë e pakënaqësi dhe se Fuqitë e Mëdha nuk kishin dëshirë ta ndihmonin.<sup>11</sup> Përveç problemeve të brendshme që kishte qeveria, asaj i mungonte edhe një bazë parlamentare e aftë të miratonte reformat dhe t’u jepte atyre legjitimitetin popullor.

Ndërsa deklaronte se Këshilli i Regjencës e kishte autorizuar të formonte një qeveri të re, njoftimi zyrtar dërguar përfaqësuesve të huaj, i kushtonte pak vëmendje faktit se përderisa në Shqipëri ishte vetëm një anëtar i këtij Këshilli (Sotir Peci), sipas nenit 49, Regjenca nuk mund të funksiononte.

Më 1 korrik 1924, qeveria njoftoi se Peci kishte dhënë dorëheqjen për arsye shëndetësore, veprim ky që e përkeqësoi edhe më shumë situatën. Tanimë jo vetëm parlamenti, por nuk funksiononte as Këshilli i Lartë, duke krijuar kështu një vakuum të rrezikshëm institucional, si rezultat i shkatërrimit dhe shpërbërjes së dy shtyllave kryesore institucionale të shtetit. Vetëm një qeveri e unifikuar dhe me vullnet të fortë mund ta kapërcente situatën dhe ta shpëtonte vendin nga anarkia, duke i rikrijuar institucionet.

---

<sup>10</sup> *Po aty.*

<sup>11</sup> Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Tiranë: Albin, 2003, f. 93.

Në lidhje me procedurën që u ndoq për krijimin e qeverisë së re me kryeministër Fan Nolin, Marchese di Durazzo, i dërguar i Jashtëzakonshëm italian dhe ministër Fuqplotë në Shqipëri, shkruante: “*Detyra e Fan Nolit për të formuar qeverinë e re i është dhënë vetëm nga një e katërta e anëtarëve të Këshillit të Naltë të regjencës. Nga tre të tjerët, njëri ishte në prag të dorëheqjes dhe dy të tjerët u arratisën*”.<sup>12</sup> Sipas artikullit 51 të Statutit të Zgjeruar të Lushnjës, kur një ose më shumë nga anëtarët e Këshillit të Regjencës ndodhej në pamundësi, për shkak vdekjeje, sëmundjeje të pashërueshme ose dorëheqjeje, në ushtrimin e mandatit të tyre, edhe një nga anëtarët e vetëm, mund të ruajë vazhdimësinë e pushtetit të sovranit. Por artikulli nuk e përmendte rastin e largimit nga vendi të anëtarëve të Regjencës, pa dhënë dorëheqjen. Nga ana tjetër, Statuti përcaktonte se Parlamenti duhet të mbledhej sa më shpejt të ishte e mundur për të vazhduar me zgjedhjen e anëtarëve që mungonin. Nga sa më sipër, mbetj e paqartë se si do ta merrte legjitimitetin qeveria e Fan Nolit. Mbetej ende për t’u vendosur nëse duhej të krijonin një qeveri provizore në një regjim ushtarak apo duhej t’u bëhej thirrje për t’u mbledhur anëtarëve të Regjencës dhe asamblastëve. Kjo dilemë do të përbënte krizën konstitucionale të kësaj qeverie.

Ministri italian Durrazo, theksonte se, gjëja më e rëndë ishte mosveprimi për të thirrur Asamblenë Kushtetuese për të miratuar kabinetin e ri. Art. 66 i Statutit, përcaktonte se, kabineti i ri kishte për detyrë të prezantohej përpara parlamentit, jo më vonë se tre ditë pas emërimit, për të paraqitur programin e tij dhe për të kërkuar votëbesimin. Në rast të kundërt, do të konsiderohej se kishte marrë mosbesimin, gjë që sillte rënien e kabinetit dhe dhënien e një detyre të re nga ana e Këshillit të Regjencës. Sipas ministrit këto ishin “dy parregullsitë më të rënda të qeverisë së re nga pikëpamja konsitucionale.”<sup>13</sup> Prandaj edhe Durrazo, mendonte se, mënyra më e mirë për të evituar vështirësitë që u përmendën më sipër, do të ishte ajo e thirrjes sa më shpejt të Asamblesë Kushtetuese, punët e së cilës, u ndërpre në nga revolucioni dhe e marrjes së votëbesimit. Ai mendonte se kabineti i Nolit mund ta fitonte votëbesimin në Asamble, pasi qeveria e re, kishte mundur të merrte një numër deputetësh pak më të vogël nga shumica e anëtarëve që përbënin

<sup>12</sup> AQSH, F. 163, V. 1924, D. 22, fl. 67-70. Telegram i ministrit italian Durrazo për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, mbi gjendjen e qeverisë së re shqiptare nga pikëpamja konstitucionale, Romë, 30 qershor 1924.

<sup>13</sup> Po aty.

Asamblenë. Ai besonte gjithashtu, se ajo do të mundte të emëronte të tre regjentët që mungonin dhe t'i jepte qeverisë fuqi të plotë për tre ose gjashtë muaj.

Akoma më i rëndësishëm ishte informacioni që jepte Durrazo se përse qeveria e re kishte refuzuar deri në këtë kohë të ndiqte një rrugë të tillë? Ai shkruante se nga diskutimet e bëra nga Fan Noli, Luigj Gurakuqi dhe të tjerë, kishte mundur të kuptonte se një nga shqetësimet më thelbësore të tyre, ishte fakti se Asambleja mund të dilte në shumicë kundër shkrirjes së saj, pasi të kishte përmbushur në dy ose tre seanca detyrat e saj, ndërkohë që qeveria e re donte të evitonte me çdo kusht vazhdimin e bashkëpunimit me këtë Asamble, “kështu siç është e përbërë ajo dhe ngaqë Asambleja ishte jashtë mase jopopullore.”<sup>14</sup> Arsyetimi i mësipërm tregon se qeveria e Nolit nuk dëshironte ta thërriste Asamblenë, pasi ishte e pasigurtë në mbështetjen e saj. Nga ana tjetër, zhvillimet treguan se ajo nuk tregonte gatishmëri, për ta legjitimuar veten as me anën e zgjedhjeve, pra me një Asamble tjetër që do të dilte prej tyre.

Po kaq interesant ishte edhe informacioni që jepte, mbi mënyrën se si kishte menduar qeveria ta kapërcente këtë situatë, duke e nxitur Asamblenë Kushtetuese të vetasgjësohej. Sipas tij, qeveria kishte si qëllim, të mblidhte deklaratat me shkrim të dorëheqjeve nga të gjithë anëtarët e Asamblesë. Kur shumica e anëtarëve të Asamblesë të kishte dhënë dorëheqjen, ishte e qartë se pakica nuk do të ishte më në gjendje të merrte asnjë vendim e kështu që nuk mund të thirrej më. “Asambleja Kushtetuese shqiptare në këtë mënyrë do të kishte vrarë veten. Kjo do të sillte nevojën për qeverinë, e cila do të mbetej detyrimisht fuqia kryesore, për të thirrur sa më shpejt zgjedhjet elektorale. Por duket se qeveria nuk ka ndër mend t'i bëjë ato para marsit tjetër dhe më e shpejta, dhjetorit që vjen”<sup>15</sup>, deklaronte diplomati italian.

Pra, duket qartë, se ekzistenca e Asamblesë konsiderohej si pengesë dhe shkatërrimi i saj, si objektiv i qeverisë, pavarësisht se në këtë mënyrë vendi do të humbiste institucionin themelor legjislativ. Kjo provon synimin e Nolit dhe përkrahësve të tij për të ndërtuar një qeverisje pa opozitën, e cila tashmë ishte dëbuar me dhunë dhe nuk mund të konkurronte në zgjedhjet e ardhshme. Ministri italian informonte më tej,

<sup>14</sup> *Po aty.*

<sup>15</sup> *Po aty.*

se: “Çështja akoma po debatohet, po në qoftë se kjo do të ishte zgjidhja, është e qartë se qeveria e re shqiptare, edhe nëse njihet nga Fuqitë, nuk mund të konsiderohet, nga pikëpamja konstitucionale shqiptare, veç se një qeveri provizore deri në thirrjen e Asamblesë së re”.<sup>16</sup> Por, nga ana tjetër, ky projekt i qeverisë ishte thjesht një dëshirë iluzive e saj, pasi shumica e anëtarëve të Asamblesë zor se mund të pranonte të vetëdorëhiqeshin.

Noli e kuptonte mangësinë që kishte krijuar mungesa e institucioneve të rëndësishme, siç ishte Këshilli i Lartë dhe për këtë arsye ai bëri të ditur se në zgjedhjet e ardhshme do të zgjidheshin edhe anëtarët e rinj të këshillit të Regjencës. Sikur të mos mjaftonte dëmtimi substancial i Këshillit të Lartë edhe Peci u largua për disa kohë nga vendi. Një dekret i qeverisë shpallte se Noli po merrte vendin e tij si anëtar i Këshillit të Regjencës sipas nenit 51. Në bazë të Statutit të Zgjeruar të Lushnjës ky ishte një uzurpim antikushtetues i këtij posti. Megjithatë, në gusht, Peci u kthye në detyrë dhe vijoi t’i bënte presion Nolit që të ligjëronte qeverinë e tij nëpërmjet një mandati popullor.

Ideja fiktive e ekzistencës së Këshillit të Regjencës, për arsye legjitimiteti, u ruajt gjatë gjithë kohës që Noli ishte në pushtet edhe pse pak njerëz brenda ose jashtë vendit e besuan përpjekjen e tij për ta paraqitur qeverinë se po vepronte brenda kornizave të Statutit të Lushnjës. Grant-Smith, në një raportim të gjendjes në nëntor, do të vërente se ajo ishte “një qeveri e përkohshme e vendosur në një kryeqytet të përkohshëm, që vepronte ilegalisht nën një kushtetutë të përkohshme”.<sup>17</sup> Kjo është një provë tjetër, e qëndrimit të saj ndaj institucioneve qeverisëse të vendit dhe ky, siç e kemi trajtuar më lart, nuk ishte një rast i izoluar apo i veçantë i qëndrimit të fituesve të kryengritjes së qershorit ndaj tyre. Megjithatë, në pozitën që ishte, qeveria e Nolit e kishte shumë të vështirë t’i rikrijonte këto institucione dhe kështu ato mbetën në nivelin e projekteve propagandistike të saj.

Ka pasur studiues, që me gjysmë zëri, e kanë pranuar ndërprerjen dhe shkatërrimin e institucioneve themelore të shtetit nga kryengritja e qershorit dhe nga qeveria e Nolit, që doli prej tij. Sipas konstitucionalistes Aurela Anastasi: “vazhdimësia e institucioneve politike të mëparshme u bë më e vështirë dhe se as që mund të bëhej fjalë për

<sup>16</sup> *Po aty.*

<sup>17</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit...*, f. 99.



vazhdimësinë e jetës Parlamentare. Këshilli i Lartë, i përbërë nga katër anëtarë, kishte mbetur me një anëtar të vetëm”. Por më tej, ajo përpiket të justifikojë sa të jetë e mundur regjimin dhe këtë defekt themelor. Ajo duke pohuar se pohon: “Fillimisht, anëtari i Këshillit të Lartë dhe Qeveria ruajtën marrëdhënie normale. Ata shfrytëzuan një dispozitë të Statutit (1922) dhe vazhduan marrëdhëniet Qeveri-Kryetar i Shtetit dhe me një anëtar të vetëm. (Këto marrëdhënie u legjitimuan nga një dispozitë e Statutit e cila parashikonte se, në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, ‘të drejtat e Këshillit të Lartë i ushtrojnë misët ose misi i mbetur dhe, në qoftë se s’ka mbetur asnjë, i ushtron përkohësisht Kryeministri’). Por, në fund të tetorit 1924, këto marrëdhënie u tronditën. Kjo ndodhi pasi u shtuan presionet për dorëheqjen e Qeverisë, që në fakt, nuk u pranuan nga Noli. Me këtë rast, Noli shtroi alternativën e zgjedhjeve”.<sup>18</sup>

Statuti i Zgjeruar i Lushnjës parashikonte se, çdo qeveri e krijuar duhej të legjitimohej më parë, përmes votimit në parlament. Qeveria e drejtuar nga Noli nuk mund ta plotësonte këtë kërkesë, pasi parlamenti ishte i shpërndarë prej grushtit të shtetit dhe qeveria nuk dëshironte ta mblidhte. Për pasojë, qeveria e Nolit, mbetet unike në historinë e qeverive shqiptare të viteve 1920-1925. *Ajo është e vetmja qeveri, e cila nuk është dekretuar nga kryetari i shtetit (Këshilli i Lartë) dhe nuk është votuar as formalisht në Parlament.* Në këtë aspekt ajo ndryshonte edhe nga tri qeveritë e mëparshme antikushtetuese (qeveritë e Q. Koculit<sup>19</sup>, H. Prishtinës<sup>20</sup>, dhe I. Kosturit<sup>21</sup>), të cilat ishin formuar nga Këshilli i Lartë ndonëse nuk kishin ardhur në pushtet në rrugë ligjore. Anëtari i vetëm në Këshillin e Lartë, Sotir Peci, refuzoi dekretimin, duke kërkuar mbledhjen e parlamentit ose kalimin në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Shumë kritik ndaj shkeljeve kushtetuese të qeverisë së Nolit ishte edhe një dëshmitar i rëndësishëm i asaj kohe, Eqrem Vlora. Ai pohonte se: “më 2 korrik 1924, kryeministri Fan Noli mori përsipër dhe

<sup>18</sup> Aurela Anastasi, *Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri 1912-1939*, Tiranë: Pegi, 2007, f. 57-58.

<sup>19</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombtar* (më tej: BKK), Legjislatura e parë, Periudha e parë, Viti 1921, Tiranë: Mbrothësija, Kristo P. Luarasi, 1921, Mbledhja e 73-të, 22 dhjetor 1921, f. 610-616.

<sup>20</sup> *AQSH*, F. 14, (pa vit), D. 82, fl. 1. Telegram i Kryeministrit Hasan Prishtina dërguar Fan Nolit, ku e njofton për marrjen e kryesisë së kabinetit të ri, 9 dhjetor 1921.

<sup>21</sup> *Po aty*, F. 147, V. 1921, D. I-18, fl. 20. Vendim i Këshillit të Naltë (Aqif Elbasani, Bumçi, M. Turtulli, Abdi Toptani) mbi formimin e qeverisë së Idhomene Kosturit, 11 dhjetor 1921.

funksionet e Regjencës, të cilat më parë i kishte ushtruar një Këshill Shteti me katër anëtarë. Kush e zgjodhi apo kush e emëroi atë? Askush! Demokratët, që për vite me radhë ishin ngjirur duke kërkuar ligjshmëri dhe liri parlamentare, vendosën tani vetë një diktaturë, e cila, për më tepër, kishte të keqen se nuk merrej seriozisht nga askush, përderisa ajo nuk zbatonte asnjë masë dhune. Mbetej kështu vetëm shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, e cila e bënte akuzuesin edhe gjyqtar, ndërsa qeverinë organ të një pushteti të pakufizuar. Lista e akteve të vogla të paligjshme të të ashtuquajturit regjim demokratik mund të mbushte qindra faqe dhe ato provojnë se masat e tij terroriste nuk drejtoheshin vetëm kundër bejlerëve të urryer, por preknin të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare”.<sup>22</sup> Edhe E. Vlora ishte i mendimit se tanimë nuk dyshonte askush, se jo vetëm vendit i mungonte pjekuria për një regjim parlamentar, por se edhe kësaj shtrese të re drejtuese të shtetit i mungonin vetitë për të udhëhequr kombin. “Nuk është për t’u habitur që në këto kushte shumica e popullsisë kujtonte me shpresë Ahmet Zogun, edhe pse të shumë ishin ata që kishin vërejtje për personin dhe mjedisin e tij. E megjithatë, ai ishte i vetmi burrë në Shqipëri që mund të rivendoste rendin dhe qetësinë dhe të cilin të gjitha shtresat e popullit, edhe në mos e donin, së paku e kuptonin”,<sup>23</sup> shkruante E. Vlora.

Megjithatë, këto masa kaq të ashpra, ndaj përfaqësuesve të regjimit të vjetër, i cili me gjithë komentet që mund të bëhen për karakterin konservator, padyshim që kishte qenë legjitim, shërbyen vetëm për forcimin e vendosmërisë së tyre në rivendosjen e *status quo*-së dhe bënë që shumë vëzhgues, “ta gjykonin qeverinë e Nolit si më autokratike se paraardhëset e saj”.<sup>24</sup>

Një qëndrim kritik ndaj kësaj qeverie, mban edhe studiuesi Afrim Krasniqi, i cili thekson se Noli kishte premtuar zgjedhje të reja, por me kalimin e muajve, i refuzoi ato. Krasniqi shpjegon se, “në nëntor presioni i madh brenda dhe jashtë vendit e detyroi atë të shpallë gatishmërinë për zgjedhje. Shkak u bë kërkesa e Këshillit të Lartë për plotësimin e tre vendeve vakante. Në këtë mënyrë, eksperimenti i dytë më i madh shqiptar me format e demokracisë moderne i krijuar nga Fan Noli, nuk pati sukses. Ai gaboi rëndë kur refuzoi të legalizojë regjimin e tij përmes

<sup>22</sup> Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1912-1925*, vëll II, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2001, f. 234.

<sup>23</sup> *Po aty*.

<sup>24</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit ...*, f. 109.

zgjedhjeve. Noli ishte i vetmi republikan në qeverinë e tij, por politika e tij ishte shumë radikale; dëshmoi mungesë përvoja në qeverisje dhe menaxhimin e saj, si dhe në kontrast me situatën, harxhoi shumë kohë me dashuritë e tij të para, librat dhe muzikën”.<sup>25</sup>

### **Karakteri i qeverisë së Nolit**

Një tipar i qartë i qeverisë së Nolit ishte *karakteri i saj diktatorial*, pavarësisht forcës relativisht të pakët të saj për të imponuar pushtetin me dhunë dhe kohës së shkurtër që ajo pati në dispozicion për ta bërë këtë. Ky tipar i saj u shfaq si në deklaratat politike të Nolit ashtu dhe në veprimet e qeverisë së tij.

Duke iu përgjigjur kritikave ndaj qeverisë së tij, si qeveri e ardhur në pushtet me dhunë, si “një guvernë pa parlament”, Noli përdori një gjuhë shumë të ashpër. Në mënyrë të papritur, ai goditi institucionet bazë të shtetit demokratik. Parlamentin e quajti “një sallë ku mblidhen politikanë pa shpirt, një sallë plot me gazra helmuese... Por meqë ju ngulni këmbë, ne jemi gati të bëjmë zgjedhje të reja dhe të mbledhim atë murtajë, atë fatkeqësi, atë besëtytni të neveritshme që është parlamenti...”.<sup>26</sup>

Goditja e ashpër që i bënte Noli një institucioni themelor të regjimit demokratik, si parlamenti, është shpjeguar shpesh me pikëpamjet konfuze në vizionin e tij. Ky fakt, jo vetëm dëshmonte për pikëpamjet konfuze të tij për institucionet politike dhe mungesën e taktit në politikë, por ishte para së gjithash, pjesë e karakterit të tij, karakter i cili, kur ishte në opozitë ishte shfaqur edhe duke sfiduar institucionet dhe duke rritur në mënyrë artificiale tensionin politik në vend, kur atij më shumë se çdo gjë, i duhej përmbajtja dhe uniteti.

Por, ndonëse e kishte propaganduar me të madhe demokracinë në opozitë, të cilën e shihte më së shumti si një propagandë anarkiste, Noli në pushtet nuk dha asnjë provë të respektit ndaj saj. Këtë e tregonin gjithë veprimet e qeverisjes së tij. Fakti që më vonë, një pjesë e madhe e mbështetësve të Nolit, mbetën të pakënaqur nga qeverisja e tij, përfshi edhe Konicën, një mbështetës konsistent i opozitës dhe Nolit, për sa i përket mënyrës së qeverisjes, shtojnë peshën kritike ndaj qeverisë së tij. Pikërisht kriza kushtetuese, keqqeverisja, si dhe tendenca shumë negative

<sup>25</sup> Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*, Tiranë: Ufo Press, 2009, f. 99-103.

<sup>26</sup> *League of Nations – Official Journal*, Special Supplement 23, Geneve: 1924, f. 101.

e dënimit të kundërshtarëve, i dha argument politik Ahmet Zogut në rikthimin e tij, të cilin e shpalli si “dita e legalitetit”. Me rikthimin e tij, Zogu do të instalonte një qeverisje të fortë, që zgjati pesëmbëdhjetë vjet, me argumentin se ish kundërshtarët e tij ishin kryengritës të rrezikshëm bolshevikë.<sup>27</sup>

Disa nga faktet që përmendëm më sipër dhe siç do analizohet edhe më tej, qeveria e Nolit kishte një karakter diktatorial por për shkak të përçarjeve të thella të brendshme, fuqia e saj ishte e limituar dhe madje në disa raste mori trajta anarkiste. Ka pasur përpjekje për ta relativizuar disi karakterin e paligjshëm dhe diktatorial të qeverisjes së Nolit. Madje, këto përpjekje kanë bërë që të ketë një konfuzion dhe kontradiktë pohimesh e vlerësimesh për ekzistencën e këtij institucioni. Në të pohohet: “*de jure*, edhe gjatë qeverisjes së Nolit u ruajt forma monarkike e shtetit, e përfaqësuar nga Këshilli i Lartë.” Më tej, pohohet se Këshilli i Lartë ishte një organ i vdekur ose “një organ formal, pothuajse pa jetë” siç shprehet autori i këtij botimi. Gjithashtu, thuhej se “Këshilli i Lartë vazhdoi të ekzistonte edhe gjatë qeverisjes së Nolit, ndonëse tepër formalisht.” Po në të njëjtin paragraf vërejmë edhe një pohim të pasaktë për shpërndarjen e Asamblesë Kushtetuese për të cilën thuhet se “pas fitores së Revolucionit të Qershorit u shpërnda vetvetiu.”<sup>28</sup>

Por, ka autorë të tjerë, të cilët kanë gjykuar me realizëm karakterin antikushtetues dhe jo serioz të qeverisë së Nolit. Kastriot Dervishi pohon se, “programi i saj mbeti larg zbatimit, e formuar në kushtet e një mbylljeje të plotë dhe e gjendur pa mbështetje financiare, qeveria shfaqti më shumë se kurrë vetitë e veçanta të anëtarëve të saj. Ajo funksiononte më tepër sipas klaneve udhëheqëse. Noli-Gurakuqi, përbënin një drejtim, grupi i ushtarakëve drejtim tjetër dhe Sulejman Delvina rrymë më vete. Rreth këtyre tri grupeve vërviteshin anëtarët e tjerë të kabinetit, duke e bërë qeverinë një mekanizëm pa autoritet dhe joveprues, ndërsa ministra të veçantë ishin ndikues vetëm në zonat e tyre të origjinës. E rrethuar nga një gjendje e tillë, qeverisë nuk i ngelej gjë tjetër, veçse të shpaloste anën diktatoriale të saj, të tregonte forcën dhe të dënonte kundërshtarët politikë me atë fuqi që kishte”.<sup>29</sup>

<sup>27</sup> TNA, FO 371/7330, fl. 875-877. Telegram i Parr dërguar MacDonald-it, mbi qeverisjen e Nolit, 28 korrik 1924.

<sup>28</sup> *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri...*, f. 344-346.

<sup>29</sup> Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë: 55, 2006, f. 216.

Mbas marrjes së pushtetit, në vend që të përpiquej vetë të grumbullonte mbështetje për ndryshimet e propozuara dhe ta kthente vëmendjen ndaj krijimit të një lëvizjeje masive, Noli ia la këtë detyrë shoqërisë “Bashkimi” dhe tentoi të përdorte forcën për zbatimin e programit. Duke modeluar variantin e tij të shtetit policor, ai e përqendroi përpjekjen kryesore në diskreditimin dhe më vonë në dënimin e anëtarëve të qeverisë paraardhëse për një sërë “krimesh” dhe kështu t’i hiqte qafe një herë e mirë. Kjo politikë ishte edhe pasqyrim i kërkesës së “Bashkimit” për luftë klasash radikale dhe një përpjekje agresive për të shkukur nga rrënjët armiqtë e vërtetë dhe mos do” të betuar të “revolucionit”. Noli nuk e vuri në dyshim vlerën e programit të shoqërisë “Bashkimi” dhe ishte i përgatitur të përdorte çdo mjet për eliminimin e çifligarëve të mëdhenj. Nga fundi i qershorit, qeveria shpalli gjendjen e luftës (fillimisht kjo ishte vendosur mbas vrasjes së dy amerikanëve) edhe për dy muaj të tjerë në prefekturën e Durrësit, për ta shpëtuar vendin nga kundërshtarët politikë.<sup>30</sup>

Në fillim të korrikut, *qeveria krijoi një Gjykatë politike*<sup>31</sup>, e cila do të merrej me problemin e vëllavrasjes, dënim që u jepej atyre oficerëve të lartë që kishin kundërshtuar ushtarakisht “Revolucionin e Qershorit”. Gjykatës i lejohej të caktonte dënime të ndryshme përfshirë edhe atë me vdekje, burgim të përjetshëm, dënim dhe konfiskim pasurie. U dënuan gati 107 njerëz vetë ku bënë pjesë edhe ish anëtarët e Këshillit të Regjencës, Xh. Ypi dhe R. Toptani, Kryetari i Parlamentit, E. Frashëri, ish Kryeministrat: A. Zogu, Sh. Vërlaci, I. Vrioni, ish ministrat, M. Libohova, A. Dibra, M. Aranitasi dhe K. Kota, së bashku me një varg ish deputetësh të tjerë, komandantë të ushtrisë dhe xhandarmërisë. Madje, duke krijuar dyshim më të madh për motivet e saj, gjykata pretendonte juridiksionin edhe mbi qytetarët e huaj, si Ceno Bej Kryeziu dhe konfiskoi pronat e të gjithë personave që kishin dalë para gjyqit pa marrë parasysh as vendimet e veta përfundimtare. Për armiqtë e regjimit të Nolit që kishin qenë shumë pa fat dhe kishin mbetur në Shqipëri, gjykata

<sup>30</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit ...*, f. 106.

<sup>31</sup> *Fletorja Zyrtare*, 1924, Viti III, Nr. 27, Tiranë, 1 korrik 1924, “Dekret Ligjë mbi gjykimin Politik”.

Gjykata Politike do të gjykonte të gjithë autorët moralë dhe materjalë të vëllavrasjes së fundit dhe shkaqeve të saj si dhe të ndihmësve kryesorë të tyre, në bazë të ligjeve në fuqi dhe vendimet e saj kishin formë të prerë.

politike urdhëroi burgosjen e tyre të menjëhershme.<sup>32</sup> *Pjesë e "reformave" të qeverisë ishte edhe ngritja e një komisioni për konfiskimin e pasurisë së gjashtë familjeve më të pasura të Shqipërisë.*<sup>33</sup>

Kjo ishte provë e karakterit diktatorial të qeverisë së Nolit dhe për më tepër, një paraqitje aspak serioze si një qeveri e rregullt, por si një institucion i paorganizuar dhe që nuk vepronte në bazë të rregullave dhe metodave ligjore.

Në historiografinë e mëparshme, është mohuar dhe mbuluar me këmbëngulje, karakteri diktatorial i qeverisë së Nolit dhe janë reklamuar vetëm projektet e tij demokratike për reformën agrare dhe fjalimet e tij propagandistike në parlament, gjatë kohës kur ishte në opozitë. Por, shumica e studiuesve të huaj kanë theksuar të kundërtën.

Kështu, Joseph Rothschild pohon se, "regjimi i Nolit, ishte i përbërë nga elementë reformatorë dhe nga feudalë, të cilët u ndanë nga vlerat e Zogut, por u ndjenë shumë shpejt të zhgënjyer nga autoriteti dhe mungesa e unitetit."<sup>34</sup> Sipas autorit, edhe pse Noli shpalli një program reformash gjithëpërfshirëse, ai bëri pak për ta zbatuar atë. Duke dashur të krijojë një imazh pozitiv ndaj opinionit publik evropian, ai shpalli angazhime mjaft liberale dhe moderne, të cilat nuk përshtateshin me realitetin shqiptar. Gjithashtu ndërtoi dhe një gjykatë politike për të dënuar kundërshtarët dhe për të konfiskuar pasuritë e tyre, në një kohë kur mund të shpallte amnistinë, ose të paktën të ndalonte ndërhyrjen politike në sistemin juridik. Mbi të gjitha, edhe pse erdhi në pushtet në mënyrë jo konstitucionale, me anë të revolucionit, Noli refuzoi ta legjitimonte pozitën e tij me anë të një plebishiti ose zgjedhjeve të përgjithshme. Në vend të kësaj, ai vendosi një censurë të rreptë.

Edhe studiuesi i njohur Misha Gleny shkruan se: "Peshkopi Fan Noli, i diplomuar në Harvard, themeluesi i Kishës Ortodokse Shqiptare në Shtetet e Bashkuara dhe adhures i betuar i kushtetutës amerikane, mblodhi një ushtri kryengritëse, e cila e rrëzoi për një kohë të shkurtër Zogun në qershor 1924. Noli atëherë qeverisi me dekrete, duke shpallur dënime me vdekje e duke ua mbyllur gojën kundërshtarëve. Gjashtë muaj më pas, kur programi naiv e i zbatuar keq i liberalizmit autokratik të Fan

<sup>32</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit ...*, f. 106.

<sup>33</sup> *AQSH*, F. 35, V. 1924, D. 137, fl. 124. Letër e motrës për Mit'hat Frashërin, Fier, 15 tetor 1924.

<sup>34</sup> Joseph Rothschild, *East Central Europe between dhe two World Wars*, Seattle: University of Washington Press, 1974, f. 361.

Nolit kishte ftohur thujtë të gjitha bashkësitë kryesore të klasës së paktë politike të Shqipërisë, Zogu çau me forcë rrugën për t'u kthyer në pushtet”.<sup>35</sup>

Bashkë me atmosferën e përgjithshme të frikës dhe manisë së persekutimit, Noli ndërmori edhe *një fushatë për eliminimin e armiqve të dyshimtë të qeverisë në ushtri, xhandarmëri dhe administratën shtetërore*. Në fund të korrikut qeveria shpalli një program ambicioz, i cili do të merrej me armiq të dyshimtë. U hoq leja për mbajtjen e armëve. Ata që kishin armë të gjata, por që nuk ishin çifte gjahu, ishin të detyruar t'i kthenin në depot ushtarake. U ndaluan mbledhjet e fshehta dhe të hapura. Pajtimi me ata që ishin cilësuar fajtorë për vëllavrasjen duhej të merrte fund, gazetat para se të shtypeshin duhej t'i kalonin censurës dhe në Tiranë e Durrës u vendos shtetrrëthimi.<sup>36</sup>

Qeveria, u përpoq që të shkurtonte burokracinë dhe të lehtësonte disi administratën e shtetit. Për këtë qëllim, u miratua Dekret-ligji “Mbi simplifikimin e burokratis e kategorizimin e nënpunsave.” Sipas këtij dekret-ligji, do të “formohet Komisioni për simplifikimin e burokratis e për spastrimin e nënpunsave”.<sup>37</sup>

Qeveria e Nolit, bëri një spastrim të thellë të administratës së mëparshme. Ky, sigurisht, ishte një veprim shtesë që plotësonte karakterin e saj revolucionar e autokratik. Lidhur me këtë veprim të saj, konsulli i parë në legatën britanike, Robert Parr, i shkruante Kryeministrit të tij, MacDonald se që nga koha kur qeveria revolucionare kishte ardhur në fuqi, ajo kishte hequr të gjithë prefektët dhe shumicën e nënprefektëve, si edhe të gjithë zyrtarët më të rëndësishëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Postet e tyre u zunë nga njerëz që kishin mbështetur revolucionin. Sipas diplomatit, ata ishin emëruar duke u bazuar në motive politike ose në lidhjet personale. “Këto masa janë diktuar nga dy motive: shpëtimi nga kundërshtarët dhe fitimi i mbështetësve të dobishëm dhe ajo e sigurimit të fitores së kandidatëve të qeverisë në zgjedhje. Asnjë datë e saktë nuk është caktuar për këtë, por njoftime konfidenciale u janë dërguar zyrtarëve më të rëndësishëm, duke

<sup>35</sup> Misha Glenny, *Histori e Ballkanit 1804-1999*, Tiranë: Toena, 2007, f. 414.

<sup>36</sup> “Shpallja e shtetrrëthimit në kryeqytet”, *Bashkimi*, nr. 3, Tiranë, 24 korrik 1924.

<sup>37</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1924, D. 184, fl.6. Dekret-ligjë mbi simplifikimin e burokratis e kategorizimin e nënpunsave, [pa datë].

i paralajmëruar të jenë të përgatitur kundrejt zgjedhjeve të mundshme në tetor”, deklaronte Parr.<sup>38</sup>

Stili diktatorial i Nolit, që nga historiografia e mëparshme është trajtuar si i nevojshëm dhe është justifikuar, nuk e ndihmoi që të fitonte aleatë brenda dhe jashtë vendit apo të siguronte ndihmën e huaj financiare. Si kreu i një qeverie, që u zotua për demokratizimin dhe modernizimin e shoqërisë shqiptare, Nolit do t’i kishte shërbyer më mirë shpallja e amnistisë së përgjithshme. Në fund të fundit ai dhe mbështetësit e tij, kishin kritikuar fuqishëm refuzimin e qeverisë paraardhëse për faljen e pjesëmarrësve në kryengritjen e marsit 1922. Ja vlen të kujtojmë, se në gusht 1923, Noli kishte deklaruar se një amnisti e përgjithshme për ata që qenë fajtorë krimesh politike ishte e domosdoshme që Shqipëria të ecte përpara.<sup>39</sup>

Megjithatë, këto masa kaq të ashpra, ndaj përfaqësuesve të regjimit të vjetër, i cili me gjithë komentet që mund të bëhen për karakterin konservator, padyshim që kishte qenë legjitim, shërbyen vetëm për forcimin e vendosmërisë së tyre në rivendosjen e *status quo*-së dhe bënë që shumë vëzhgues, “ta gjykonin qeverinë e Nolit si më autokratike se paraardhëset e saj”.<sup>40</sup>

Ajo që e dallonte në thelb qeverinë e Nolit, nga qeveritë e mëparshme, lidhur me këtë çështje, ishte fakti se në opozitë, ai kishte luftuar të amnistoheshin aleatët e tij që kishin marrë armët kundër rendit kushtetues apo kishin kryer grushte shteti, ndërsa dënimet e Nolit në qeverisje ishin drejtuar kundër anëtarëve të një qeverie legjitime, të cilët nuk kishin kryer asnjë shkelje serioze kushtetuese apo ligjore. Dhe ai po tregohej i vendosur për t’i shkuar këtij ndëshkimi deri në fund. Një dallim tjetër esencial, ishte edhe masa e dënimit. Gjykatat gjatë kohës së qeverisjes së Nolit dhanë dënime shumë më të ashpra se ato të periudhës paraardhëse. Duhet kujtuar se krerët kryesorë që organizuan grushtet e shtetit, vetëm sa ishin dëbuar nga Shqipëria nga qeveritë paraardhëse, po kështu edhe figurat qendrore të organizimit të kryengritjeve dhe lufta e Nolit atëherë ishte drejtuar ndaj qeverisë, e cila vetëm nuk pranonte kthimin e shpejtë të tyre brenda vendit.

<sup>38</sup> TNA, FO 371/7330, fl. 889. Telegram i Parr për MacDonald mbi qeverinë e Nolit, 18 gusht 1924.

<sup>39</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit ...*, f. 109.

<sup>40</sup> *Po aty*.



Qeveria nuk u tregua aspak tolerante ndaj sulmeve në shtyp dhe reagoi me masa represive. I tillë ishte rasti i gazetës “Tirana”, e cila u padit “për trajtime tendencioze dhe antiqeveritare” dhe u ndalua me vendim të gjyqit ushtarak.<sup>41</sup> Një masë e tillë ishte një shmangie nga programi i shpallur i qeverisë (“sigurimi i të drejtave”- pika 8) dhe në përgjithësi nga parimet bazë të një qeverie demokratike. Përballë aktivizimit gjithnjë e më shqetësues të elementit kundërshtar, sidomos prej gjysmës së dytë të muajit gusht, qeveria vendosi të merrte masa emergjente për të mbrojtur rendin e ri të qershorit. Ajo vendosi të adoptonte “kursin e dorës së fortë” dhe shkoi deri në masa të jashtëzakonshme si “shtet-rrethim, ndjekje operative” etj.

Studiuesi Puto është përpjekur të justifikojë karakterin diktatorial të qeverisë së Nolit dhe masat represive të saj duke pohuar, se vetë Noli do të shprehej më vonë se, gjithsesi, “jeta e kundërshtarëve ishte po aq e mbrojtur sa edhe ajo e partizanëve të qeverisë”.<sup>42</sup> Në të vërtetë, ky pohim i Nolit i marrë në këtë mënyrë jo kritike, nuk mund të maskojë karakterin represiv të masave të qeverisë.

Në anën tjetër, është pranuar se ka pasur efekte negative, sidomos në opinionin e jashtëm, vendimi që u mor në korrik për hapjen e “Gjyqit politik” kundër krerëve të regjimit të përmbysur me Zogun në krye (pika 2 e programit). Çështja u trajtua, së pari, nga prokuroria, e cila paraqiti pretendencën e saj më 16 tetor. Ajo u pasua nga vendimi i “Gjykatës hetuese pranë Gjyqit politik” më 25 tetor. Mbi bazën e akuzës si “shkaktarë të vëllavrasjes” të formuluar kundër tyre, Gjyqi politik e dha vendimin më 12 dhjetor duke dënuar me vdekje dhe me sekuestrim të pasurisë A. Zogun, Ceno Kryeziun, Shefqet Vërlacin, Koço Kotën etj.<sup>43</sup>

Madje, krijimin e Gjykatës Politike e kritikoi edhe “Vatra”, e cila ishte mbështetëse e vendosur e qeverisë së Nolit. “Dielli”, në këtë periudhë, shkruante: “Është e para herë në histori, që revolucionarët hapin një gjyq për të kërkuar shkakëtarët e revolucjes, që të dënojnë jo veten e tyre, po ata që kundërshtuan revolucjen”. Sipas “Vatrës”: “Shefqet Vërlaci me Ilias Vrionin, duke kundërshtuar lëvizjen revolucionare, bënë detyrën e tyre si njerës të guvernës. Përderisa populli ka të drejtën në disa raste të bëjë revolucion, qeveria ka gjithmonë për

<sup>41</sup> *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri...*, f. 358.

<sup>42</sup> *Po aty*, f. 350-351; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 360-361.

<sup>43</sup> *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri...*, f. 358

detyrë të kundërshtojë lëvizjet revolucionare. Guverna e Shefqet Vërlacit është më e liga që ka patur Shqipëria në pesë vjet e sipër; po ndonëse e ligë, ish padyshim guverna legale e vendit”.<sup>44</sup>

Duke u përpjekur ta minimizojë këtë veprim të rëndësishëm, që provon karakterin diktatorial të qeverisë së Nolit, Arben Puto, thekson se “vetë data e këtij vendimi e bënte atë të tepërt dhe krejt formal, 10 ditë përpara rrëzimit të qeverisë”. Ai është mjaftuar vetëm duke e komentuar, si “një gabim, që u shtojë gabimeve të tjera dhe që tregonin mungesë realizmi në politikë. Ato e dëmtuan rëndë imazhin e qeverisë. Anglia dhe Franca protestuan nëpërmjet përfaqësuesve të tyre”.<sup>45</sup>

Por, përfaqësuesi britanik, R. Parr, që më 18 gusht, informonte se gjykata nuk ishte një institucion vetëm në letër. Ai informonte Kryeministrin MacDonald se: “Gjykata Politike e themeluar nga qeveria revolucionare, pas një periudhe qetësie, ka treguar shenja të aktivitetit të saj dhe gjatë javës që kaloi ka dhënë instruksione për një numër të konsiderueshëm arrestimesh. Ndërmjet këtyre, dy-tre persona me rëndësi janë arrestuar.”<sup>46</sup> Ai informonte se mes të arrestuarve ishte dhe Vasil Dilo, avokat dhe publicist i njohur i Gjirokastrës. “Ai është një i krishterë, burrë i ndershëm, i patundur, edhe pse kritik, mbështetës i Ahmet Zogut. Ai refuzoi të linte vendin dhe vazhdoi të publikonte gazetën e tij, e cila e kritikonte revolucionin si të dhunshëm dhe të padrejtë. Ai tashmë është arrestuar me akuzën e publikimit të një artikulli që tenton të nxisë antagonizmin mes myslimanëve dhe të krishterëve.”<sup>47</sup>

Puto ngre alibinë se edhe Eqerem Vlora kishte theksuar butësinë dhe karakterin teatral të këtyre dënimeve. Ai shkruan: “T’i besohet Eqerem beut kur citon Nolin, apo e bën këtë për të diskredituar qeverinë si inkoshiente? Ndoshta synon të përqeshë liberalizmin e Nolit, kur ai thoshte se ‘kundërshtarët ishin po aq të mbrojtur sa dhe partizanët e qeverisë’. Tek e fundit, duket se vetë Noli nuk i ‘besonte’ gjyqit politik. Në fakt, në një bisedë me të ngarkuarin me punë të Anglisë, Noli thotë hapur se ‘gjyqet politike janë vetëm një stoli dekorative pa funksion

<sup>44</sup> Shënime, “Vëllavrasja dhe Gjykatoria Politike”, *Dielli*, Boston Mass., 9 shtator 1924.

<sup>45</sup> A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 362.

<sup>46</sup> TNA, FO 371/7330, fl. 884-887. Telegram i Parr dërguar MacDonald-it për “Klikën”, Durrës, 18 gusht 1924.

<sup>47</sup> *Po aty*.

praktik, sepse nuk do të zbatohen'. Gjyqet politike ishin, pra, më tepër një fasadë revolucionare".<sup>48</sup>

Mund të mendohet se hapja e proceseve kundrejt personaliteteve të regjimit të rrëzuar, ishte një mënyrë për të kompensuar pasivitetin dhe pafuqinë e qeverisë në frontin kryesor të reformave. Programi praktikisht po mbetej në letër. Për reformën agrare, që ishte pika qendrore e programit, u fol shumë. U ngrit edhe një komision i posaçëm pranë Ministrisë së Bujqësisë, u porositën edhe prefekturat që ta ndiqnin çështjen. Por, qeveria nuk ishte në gjendje të merrte masa konkrete për zbatimin e saj në praktikë.<sup>49</sup>

Marrja e pushtetit në qershor nga Noli, kishte pasur prejardhje komplekse. Ajo nuk ishte thjesht rezultat i betejës ndërmjet çifligarëve dhe reformatorëve me mendime liberale, siç është përpjekur ta portretizojë historiografia e mëparshme, nuk ishte as një revolucion demokratiko-borgjez. Ishte një klasë e vogël borgjezie, që gjendej në pakicat katolike dhe ortodokse por që krijoi vetëm një fraksion të lëvizjes. Siç ka nënvizuar R. Austin, "në fillim të viteve '20 ekzistonte një luftë ndërmjet *status quo*-së dhe progresistëve. Megjithatë, marrja e pushtetit që gjithashtu rezultoi i luftës së individëve, i karrierizmit dhe antagonizmave të ashpra krahinore".<sup>50</sup>

Në këtë përcaktim të saktë të Robert Austin, mund të zbulojmë gjithashtu edhe zbulimin e kësaj ngjarjeje nga historiografia e mëparshme, e cila, tek i ashtuquajturit "revolucion i qershorit", ka parë vetëm një element, elementin liberal duke e glorifikuar atë. Por, ideja e revolucionit, nuk ishte asgjë më tepër, se sa një frymëzim utopik dhe pa asnjë bazë, i një fraksioni të vogël, të opozitës që drejtohej nga Noli.

Kryengritja e qershorit, e cila siç e kemi thënë, ishte thjesht një grusht shteti, nuk kishte asnjë lloj përgatitje programatike, por mbi të gjitha nuk kishte ndonjë mbështetje serioze ose të afirmuar nga ndonjë shtresë e rëndësishme sociale që të përbënte bazën e saj. Prandaj, ajo mund të cilësohet si një aksident historik, që ndërpreu zhvillimin ligjor të institucioneve të shtetit shqiptar në një rrugë demokratike dhe evolutive, pa pasur asnjë premisë që të sillte një ndryshim pozitiv në shoqërinë shqiptare. Përkundrazi, ky eksperiment gati femënor, i një pjese të klasës

<sup>48</sup> A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 363.

<sup>49</sup> *Po aty*.

<sup>50</sup> R. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit ...*, f. 106.

së atëherëshme politike ishte shumë i rrezikshëm për interesat e vendit dhe mbartte rreziqe tepër të mëdha.

Me pesë parimet bazë të revolucionit dhe tri qendra krahinore të pakënaqura, ishte e pamundur që të ruhej uniteti, shpjegon Austin. Vrasja e Avni Rustemit, e cila përshpejtoi kryengritjen, kishte ndodhur në një kohë kur forcat e opozitës akoma duhej të siguronin një program që do të arrinte diçka më shumë se uniteti i sipërfaqshëm. Vetëm një pjesë e vogël e atyre që u përfshinë në marrjen e pushtetit në qershor, ishin në gjendje të artikulonin një program sistematik. Megjithatë, Noli u përpoq ta merrte, atë që në thelb ishte një grusht shteti, me qëllime shumë të kufizuara dhe ta kthente në një revolucion shoqëror. Këtu ai dështoi, dhe forcat që e kishin ngjitur në krye, qenë po aq të gatshme për të lehtësuar rënien e tij. Nga fundi i nëntorit, eksperimenti i Nolit mori fund. Koalicioni nga brenda ishte çarë në mënyrë të pariparueshme.<sup>51</sup>

*Falimentimi ekonomik e shkatërroi më tej autoritetin e qeverisë dhe e çoi vendin në prag të anarkisë, duke sjellë një dëshpërim të thellë në vend dhe kjo qartësisht provon se dështimi në radhë të parë, ishte produkt i qeverisjes së keqe. Pastaj do të vinte ndërhyrja e Zogut me atë mbështetje të jashtme që ai siguroi, e cila, ka qenë më shumë politike se sa ushtarake.*

Në pak kohë, Noli synoi të vinte themelet e një politike të re të brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë duke zbatuar masa radikale. Por, ai dështoi sepse mungonin gati tërësisht premisat për një gjë të tillë. Përvoja e Shqipërisë dhe e Nolit në këtë periudhë, nuk ndryshonte shumë nga ajo e shteteve të tjera të Ballkanit. Rasti i Shqipërisë, si në planin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm, tregon qartë sa i vështirë ishte realizimi i këtij programi.

Shumë nga ato që u përpoq të zbatonte Noli, ishin të vështira. Atij i mungoi mendjempërhtësia politike, për t'u orientuar në klimën tejte të vështirë, që mbizotëronte në Ballkan, mbas Luftës së Parë Botërore. Vënia në jetë e këtij vizioni, për Shqipërinë, do të kishte qenë një sfidë monumentale, madje edhe për politikanët më me përvojë. Kudo në rajonin e Ballkanit, forcat që ishin për *status quo*-në kishin fuqinë në dorë dhe Noli nuk ishte i vetmi politikan që pësoi disfatë. Nuk ishte as i vetmi udhëheqës në Ballkan, që u ndesh me indiferencën e Fuqive të Mëdha

<sup>51</sup> *Po aty*, f. 107.

dhe të Lidhjes së Kombeve. Megjithatë, Noli u përball edhe me disa pengesa që ishin specifike si për të ashtu edhe për Shqipërinë.<sup>52</sup>

Ndërsa Noli e shihte luftën ndërmjet rendit të ri dhe atij të vjetër, si luftë ndërmjet të mirës dhe të keqes, kaosi politik që sundonte në vitet që pasuan Kongresin e Lushnjës, ishte më i ndërlikuari. Ai ishte kështu, vetëm pjesërisht përfundim i luftës mes versionit të Nolit për liberalizimin dhe reformimin e pronësisë mbi tokën dhe regjimit të vjetër. Përpjekja e dytë për krijimin e shtetit, që erdhi me Kongresin e Lushnjës, nxori në sipërfaqe, jo vetëm kundërshtimet e ashpra, që nuk ishin zgjidhur në vitet paraardhëse por, edhe mundësi të reja. Këtu hynte trashëgimia për zgjim kombëtar që duhej akoma të bashkonte vendin.<sup>53</sup>

Ishte pikërisht shumëllojshmëria e pikëpamjeve, ajo që e bëri periudhën para ardhjes së Nolit në pushtet, kulmin e jetës politike shqiptare në kohën mes dy luftërave, por edhe një periudhë tërësisht pa arritje politike esenciale. Madje, çështjet më themelore u lanë pa prekur, ndërsa Shqipëria zhytej thellë e më thellë në kaos.<sup>54</sup> Këtij përfundimi mjaft të argumentuar të Austin-it, i duhet shtuar edhe fakti, se ato që u penguan në këtë proces kaotik dhe të dhunshëm politik, ishin institucionet kombëtare, të cilat ngelën në një trajtë rudimentare, amorfe, të pastabilizuar dhe mund të themi në një gjendje dëshpëruese.

Sfida kryesore e qeverisë ishte njohja ndërkombëtare e saj. Sipas të drejtës ndërkombëtare, një qeveri mund të përfaqësojë shtetin e saj sa kohë që kushtetuta e brendshme e vendit (në bazë të së cilës formohet qeveria) është në fuqi dhe veprimi i saj nuk është ndërprerë. Për këtë arsye, çdo ndryshim qeverie, i bërë në bazë të kushtetutës ose i parashikuar prej saj, cilësohet si “i zakonshëm” “konstitucional”, një ndryshim i tillë nuk shtron problemin e njohjes. Nga ana tjetër, “në qoftë se qeveria, që është krijuar në bazë të kushtetutës, rrëzohet me anë të një kryengritjeje ose të ndonjë grushti shteti (pavarësisht se ka gjakderdhje apo jo) dhe zëvendësohet me një qeveri tjetër, atëherë këtu kemi të bëjmë me një ndryshim të jashtëzakonshëm”, që del jashtë kuadrit të kushtetutës.<sup>55</sup> Ky ishte thelbi i problemit. Për këtë arsye, qeverisë së Nolit i nevojitej largpamësi dhe vendosmëri për të realizuar me sukses dhe me

<sup>52</sup> *Po aty*, f. 215.

<sup>53</sup> *Po aty*, f. 216.

<sup>54</sup> *Po aty*.

<sup>55</sup> Arben Puto, *Probleme juridike të Pavarësisë shqiptare*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Tiranë: 1965, f. 178-179.

shpejtësi të gjitha masat që do ta legjitimonin atë dhe do t'i siguronin njohjen ndërkombëtare.

### *S u m m a r y*

#### THE INSTITUTIONAL CRISIS AND THE CHARACTER OF FAN NOLI'S GOVERNMENT

In the field of governance, Albania with Noli took a big step back, which had negative consequences in all other institutions. Noli's taking over the post of Prime Minister was completely contrary to the Lushnja Statute and, consequently, completely illegal. At this time, in addition to the parliament, the High Council was dissolved, which had been a functional and accepted institution, before the events of June. Thus, a dangerous institutional vacuum was created, as a result of the destruction of the two main pillars of the state: the Parliament and the Regency. This fact, together with the army's commitment to overthrow the previous legitimate government, were enough to qualify Noli's government as an illegitimate government and his coming to power as a coup d'état.

The June revolution had no programmatic preparation, but above all there was no serious support or from any important social stratum to form its basis. Therefore, it can be considered as a historic accident, which interrupted the legal development of the institutions of the Albanian state in a democratic and evolutionary way, without having any premise to bring a positive change in Albanian society. On the contrary, experiment of a part of the political class of that time was very dangerous for the interests of the country and carried great risks.